



Elaine Tokaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË  
SENATI AKADEMIK



Nr. 2825 Prot.

Vlorë më. 05.12.2024

VENDIM  
Nr. 87, datë 04.12.2024

**PËR SHTYRJEN E AFATIT TË ÇELJES SË PROCEDURËS PËR  
VETËKANDIDIM PËR ANËTAR PËRFAQËSUES I STUDENTËVE NË  
KOMISIONIN INSTITUCIONAL ZGJEDHOR STUDENTOR (KIZS) DHE  
KOMISIONIT TË APELIMIT STUDENTOR (KAS).**

Në mbështetje të nenit 38, 39, pika 12, të ligjit Nr.80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", nenit 19, të Statutit të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë, nenit 6, pika 3, nenit 8 të Rregullores "Për zgjedhjen e këshillave studentorë në universitetin "Ismail Qemali", Vlorë, referuar shkresës 2770, prot, datë 02.12.2024, Senati Akademik në mbledhjen e tij të radhës datë 04.12.2024

**VENDOSI:**

1. Të miratojë shtyrjen e afatit për çeljen e procedurës për vetëkandidim për anëtar të Komisionit Institucional Zgjedhor (KIZS) si dhe Komisionit të Apelit Studentor (KAS) në UV.
2. Komisioni Institucional Zgjedhor (KIZS) të jetë i përbërë nga 5 (pesë) anëtarë, 1 (një) përfaqësues për çdo fakultet. Fakulteti që ka numrin më të madh të studentëve do të ketë 2 (dy) përfaqësues, të gjithë me të drejtë vote.
3. Komisioni i Apelit Studentor (KAS) të jetë i përbërë nga 3 (tre) anëtarë, me mandat dy vjeçar, të cilët nuk kanë të drejtë të kandidojnë për poste të tjera gjatë mandatit si anëtarë të KAS.
4. Kjo periudhë do të zgjasë prej datës 04.12.2024 deri më datë 11.12.2024.
5. Vetëkandidimet do të dorëzohen në Zyrën e Protokollit të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë dhe do të administrohen nga sekretaria e Senatit Akademik.
6. Ngarkohet Drejtoria e Komunikimit dhe Burimeve Njerëzore për shpallje në faqen Web të vendimit dhe bërjen e njoftimeve përkatëse.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

**KRYETARI I SENATIT AKADEMIK**

Prof. Dr. Aurela Sahaj

